
ABOUT THE FIRST OF THE ALBANIANS SETTLEMENT IN GREECE MBI GJURMËT E PARA TË SHPËRNGULJES SË SHQIPTARËVE NË GREQI

SHKELZEN RAÇA

Instituti Albanologjik, Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS
shkelzen.raca@yahoo.com

AKTET V, 4: 726 - 730, 2012

PERMBLEDHJE

Problemi bosht i trajtimit, ka të bëjë me shpërnguljen e shqiptarëve në Greqi, pra të shtrirjes së arbitit tutje kufijve ekstremë të Shqipërisë sot. Kihet të bëhet fjalë për epokën e Mesjetës, atë të shek. XIII, kur si pasojë e zhdukjes së bërthamës arkaike e të lëkundshmërisë sociale merr krahë procesi gradual i shtegtimit dhe i migrimit të fshatarëve të varfër të shqiptarëve mesjetarë. Në këtë drejtim, janë shtruar pikat kronologjike të vendosjes së tyre në viset fillimisht malore, e më pastaj fushore të Tesalisë. Punimi pretendon të japë përgjigje në pikat vijuese, si: në ç’kohë përafërsisht nisi procesi i shpërnguljes së shqiptarëve të Mësjetës drejt Greqisë? }’motive i nxitën ata të marrin rrugën e mërgimit? }farë trajtash organizative pati kjo dukuri demografike; cili ishte “atdheu i parë” i “akomodimit” të tyre jashtë Arbërisë dhe ç’kontribut ata patën në historinë e Greqisë mesjetare?**Fjalët kyçe:** demokraci, informacion, zgjedhje politike, teoria e lojes

Fjalët kyçe: Mesjeta, gjurmët, shpërngulja, shqiptarët, Shqipëria, Greqia, Tesalia.

SUMMARY

The main issue of treatment of this paper is about the displacement of Albanians in Greece, therefore of the settlement of Arbri beyond the extreme boundaries of nowadays Albania. It has to do with Middle Ages epoch, that one of XIIIth century, when as a consequence of the disappearance of the archaic core and social insecurity, the gradual process of displacement and the migration of poor Middle ages Albanian peasants took place. In this way there are placed, at the beginning chronological points of their settlement in rural areas, and then in lowlands of Thessaly. This paper pretends to give answers at the following points as approximately, at what time the process of the Middle Ages Albanians displacement has started towards Greece? Which motives pushed them towards migration? What kind of organizations had this demographic phenomenon? Which was their “first accommodation homeland” out of Arberia and what contribution did they have in the history of Middle Ages Greece?

Key words: Middle Ages, traces, settlement, Albanians, Albania, Greece, Thessaly.

1. Hyrje

Shkenca e historisë në përgjithësi dhe ajo e kërkimeve në fushën e bizantologjisë në veçanti, deri më tani i ka kushtuar një hapësirë relativisht të gjerë studimi problemit të dyndjeve e lëvizjeve etnike, që për pasojë patën krijimin e rrethanave të reja në planin demografik. Padyshim se, nga dukuria e ndryshimit të trendeve etnike, të nisura që nga shek.VI, nuk do të kursehet as Gadishulli Ballkanik.

Në këtë rrafsh ndryshimesh demografike, madje që në prak të rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit, hapësira tokësore e Greqisë, si dhe pjesa më e madhe e rajonit, ku më pak e ku më shumë, pësojnë ndryshime në kuadrin e gjeografisë së tyre etnike. Për gati dhjetë shekuj, gati se gjithandej rrypit bregdetar dhe pjesës më të madhe të hinterlandit në vendin e sofistëve të Heladës antike, do të zënë vend e do të

asimilohen relativisht shpejt ca grupe etnike, të cilat shkelën aty.

Ndryshe në këtë kontekst qe fati i arbitrit. Elementi mesjetar shqiptar, i cili mori botën në sy, duke shtrirë më pas krahët e vendosjes në Greqi, kishte qenë që në shek.XI etni e konsoliduar. Shqiptarët me fjalë të tjera, ata të mesjetës së hershme, kishin pasur gjuhën, doket e zakonet e tyre, sa edhe prirje në ruajtjen e jetës patriarkale, tipare këto që i bënë ata edhe për shumë kohë etni në vete. Dhe rrjedhimisht nga kjo, ata, jo vetëm në truallin e tyre, por edhe në dhe të huaj, nuk përjetuan fatin e zhbërjes ose të asimilimit.

Mirëpo, kjo cilësi e admirueshme nuk mjaftoi, që ata t'i shpëtonin migrimit, drejt jugut e tutje Adriatikut. Shqipëria, ajo e gjysmës së dytë të shek.XIII, pavarësisht nga krijimi i identitetit të fortë etnik, nga pikëpamja shoqërore e ekonomike mbeti një vend me probleme të mëdha. Burimet historike të kohës, sikurse edhe vetë terri mesjetar, nuk japin në hollësi detajet e krizës që e kishte kapluar "Arbërinë", porse literatura historike bën të ditur për një tronditje të thellë të popullatës, në planin ekonomik e politik. Kështu, "Regnum Albaniae" e anzhujëve kishte ngarkuar banorët e qyteteve me taksa të papërballueshme (Shufflay:189), ndërsa prona e përbashkët, nisi të tjetërsohej, duke prodhuar një cikël të ri social. Në Shqipërinë e shek.XIII nisi procesi i diferencimit social, më pastaj të grryerjes graduale të institucionit të fisit, ndërkaq, në mungesë të tokës së bukës e krijimi rrethanash të reja, shfaqet fenomeni i zbritjes të një pjese të popullatës në vise fushore e lugina. Dhe mungesa e gjetjes për një tokë të re pune, fillet e varfërisë së skajshme, shfaqja e anarkisë feudale, dhuna e ushtruar nga sundimi i huaj, janë faktorë që nxitën shpërnguljen (Ducellier:19-44; Shkodra: 239-255).

2. Në fillet e lëvizjeve jashtë Arbërisë

Në literaturën ekzistuese historike, si dhe në burimet e botuara deri më sot, shtegtimet e arbitrit prezantohen si nismë e braktisjes së truallit amë. Ky fenomen demografik drejtohet nga malësorët e veçuar, të organizuar në grupe ose nga tarafet e ndryshme, që "merr krah" në

shek.IX-X. Megjithatë, në mungesë baze burimore, krejt kjo mbetet në suaza supozimi, nga se për shekujt e hershëm të mesjetës, Shqipëria është pak e pranishme në bazën dokumentare, sa në atë të proveniencës latine, po aq edhe në atë të gurrës bizantine.

Sido që të jetë, bëhet fjalë se, aty rreth viteve 1021-1022 ndodhi një shtegtim malësorësh të arbitrit drejt viseve të Greqisë (Historia e popullit shqiptar:158). Këtë vijë mendimi, paraprakisht e promovuan edhe disa autorë të tjerë, të cilët këmbëngulnin se, një dukuri e tillë duhej të ketë ekzistuar (Kersopoulos: 20; Μπίρης: 46). Mirëpo, ky trend lëvizjeje apo ngulimi të përhershëm larg nga Arbëria, nuk kishte ndonjë adresë të saktë. Konsideroj se, kihej të bëhej për një shtegtim sezonal, individual e të paorganizuar.

Mbase, rrymat migruese të shqiptarëve të mesjetës, fillojnë nga një trend vertikal demografik, që nuk nxiten edhe gjithaq nga prania e sundimit të huaj. Përrjashtim bënin feudalët freng të Napolit, të cilët, sipas teksteve të kohës, aty rreth viteve 1269-1274 kanë dorë në lëvizjet e tyre, megjithatë të pakta në numër, drejt jugut ekstrem të Shqipërisë. Nuk është e rastit, prandaj, se po ata përmenden afërsisht më 1300, në Tesali (Jochalas: 32-33), ndërsa një zhvendosje e shqiptarëve ndodhi, gati se njëkohësisht, në drejtim të kundërt. Indikatorët e kësaj dukurie vihen re si pasojë e varfërisë së madhe, e drejtuar pikërisht nga sundimtarët e huaj "Regnum Albaniae". Konfirmohet kështu, "marrja e botës në sy" prej një grupi shqiptarësh, duket shumica në Durrësi, të cilët me dro e zemërim nxitojnë drejt Apulisë, duke kërkuar lëmoshë (Ducellier: 13) Të ndodhur përballë rivalitetit të krishterizmit perëndimor me atë lindor, tronditjeve të mëdha sociale, një pjesë e arbitrit, që konsiderohej pjesë e universit shpirtëror të Bizantit, tani më në kushte të rënda ekzistenciale synon tokë të re pune dhe kushte tjera jetese.

3. Tesalia -vendngulim përmasash të gjera

Në funksion të trajtimit historik të hedhjes së arbitrit në Greqinë mesjetare, një përfaqësues i lagjes së burimeve tregimtare bizantine ngreh

çështje nga trendet demografike të shqiptarëve brenda botës bizantine. Është fjala për Halkokondilin, i cili përmend skicën e migrimit kah Helada e lashtë, duke marrë për bazë nisjen e tyre nga Durrësi, qëndrimin e përkohshëm në Maqedoninë e Greqisë së sotme dhe ashtu duke shtegtuar, fundin e itinerarit e vendosë me “pushtimin” e Tesalisë (Chalkokondilae: 196-198). Nuk di për ndonjë datë të saktë, natyrshëm në mungese dëshmie të sigurt, porse një grup jo i vogël shqiptarësh identifikohen si banorë në masivin malor të Tesalisë Veriore. Bëhet e ditur kjo, nga një dokument i vitit kalendarik 1295, (Niklosich-Müller: 260). kur ata nuk mirëpritën nga anasit aty, që parashtrojnë ankesën e tyre pranë sundimtarit lokal të Bizantit. Sipas tyre, përjashtim bënin vetëm ata, të cilët kishin zënë vend me “dekret të perandorit” aty (Gregorae: 545; Βακαλοπούλος: 27).

Ishte koha kur, gjurmët e para të shqiptarëve mesjetarë, të ardhur jo nga deti por nga toka, po lëviznin ende sporadikisht, duke qëndruar përkohësisht në rajonet malore të Tesalisë. Ata udhëheqin ende një jetë fluide, duke synuar sigurisht “akomodim” aty afër Fanarit, një qytet ky i fortifikuar në këtë rajon veriperëndimor të Greqisë. Nisur nga kjo, prandaj, kalendari historik identifikon valë të fuqishme e të organizuar të arbitrit këtu. E përdorshme këtë herë është kronika e venedikasit, Marin Sanudo, i cili zë ngoje shqiptarët në përpjekje për të “pushtuar” një autonomi të gjerë nga sundimtarët lokalë bizantinë. Rrëfimi i tij kap fillimisht vitin 1315, ndërsa letra e tij e tretë bën fjalë për shqiptarët si etni e padëshirueshme, si për grekët, ashtu edhe për katalonasit, gjithashtu të huaj në Tesali (Lluch: 160; Πούλος: 43; Jochalas: 91). Për më tepër, baza burimore tregimtare e Bizantit bën të ditur që atëherë se banorët e rinj ishin “akomoduar” aty, duke u bërë të mirënjohur për shtresën e lartë ushtarake të perandorëve bizantinë. Supozimi çon tek funksioni i administratorit ushtarak, Sirjanit, i cili kishte njohur disa fise nomadësh (Cantacuzeni: 24, 450; Bozhor-Liço: 220-221) dhe se ndoshta kishte kërkuar ndihmën e potencës së tyre ushtarake, që para vitit 1315.

Dhe pavarësisht ligjeve të egra demografike, ata ishin në rrugë krijimi parakushtesh të favorshme, si dhe të një dinamikë të organizuar ngulimi, në tokën e tyre të re. Fillimisht i nënshtrohen pushtetit perandorak të Bizantit, ndërsa për pak kohë, pas anarkisë në Tesali, ata ofrojnë shërbime ushtarake, duke gëzuar famën e një force reale militariste aty.

4. Tri tarafe -faktorë vendosës të arbitrit në Tesali

Po, cila ishte gjeografia e lëvizjes së shqiptarëve dhe kush ishin ata shqiptarë, që ndërtuan uara komunikimi me të parin e Bizantit ?

Ishte e vetëkuptueshme që për shkak të afërsisë, djepi i parë i tyre duhej të kishte qenë Shqipëria e Jugut, ndërsa deri tek ardhja në rrafshnaltën e Tesalisë, shërbeu aksi jugor Durrës-Devoll. Konsideroj po ashtu se, në gjurmët e shpërnguljes më masive drejt Tesalisë, ata dëshmojnë prirje të përkohshme të një shtegtimi, tok me gra, fëmijë e gjësende të tjera, drejt gjetjes të një toke të përdorshme për mbijetesë.

Nuk jam në dijeni për numrin e tyre, as për kushtet konkrete të jetesës së tyre. Di vetëm për faktin se ishin të organizuar në fise, tri prej të cilave dihen me emrat e tyre. Por, përveç emra tarafesh, nuk kam në dispozicion ndonjë të dhënë të drejtpërdrejt për organizimin e brendshëm, po aq sa edhe për nivelin e zhvillimit dhe dallimet eventuale Brenda grupit, pastaj për kushtet e klerarkisë, të komunikimit e të këmbimeve materiale.

Me pak fjalë, nuk kam në dorë të gjitha ato që kërkohen për të kuptuar si bëhej lëvizja e një grupi që rikërkonte kushte më të mira ëtë vendosjes. Di ndërkaq, vetëm për një numër anëtarësh të këtyre fiseve: 12.000 shpirtëra apo 12.000 familje dhe që të dy këto shifra janë të mundshme. Dihet poashtu se perandori bizantin, Androniku III Paleologu kishte lidhur një marrëveshje me shqiptarët e atyre fiseve. Një burim tregimtar bizantin përkujton kjo degë e arbitrit, që nuk njihnte “mbret” dhe që gjatë të ftohtit të madh, po ky u lejoi të ardhurve nga Arbëria zbritjen në ndonjë qytet të fortifikuar (Cantacuzeni: 28, 474; Σούλης: 213).

Në këtë kontekst, ardhacakët nga Shqipëria e Jugut, pas rropatjeve të mëdha e shpërblejnë të parin e Bizantit, duke u vënë në shërbim të pushtetit të brishtë të tij, që vlonte nga kundërthëniet e thella ndërmjet sundimtarëve lokalë dhe veprimeve të hapta të sundimtarëve latinë (Zakythinos: 103). Pra, perandori bizantin i nënshtroi "ilirët", vetëm pas vënies së kontaktit me fiset Bua, Mallakasi dhe Mesariti, të cilët padyshim se përbënin boshtin e arbitrit të shpërngulur në Tesalinë e pasur atëherë. Ai tash e tutje do t'u mundësonte po atyre tarafeve hapësirë të lirë lëvizjeje, duke i shndërruar njëherit ata nga grupe nomadësh në gjysëm nomadë, si dhe në blegtorë zhvendosës.

Sidoqoftë, e rëndësishmja në disa dilema vitesh rreth kohës së vendosjes masive të shqiptarëve në "tokën e premtuar" që quhej Tesali, ata për kohën lanë gjurmë të dukshme në jetën mesjetare të "atdheut të tyre të parë". Tarafet Bua, Mesariti e Mallakasi janë ato, që imponojnë forcën e tyre ushtarake si burim të pashterrshëm mobilizimi, sa për sundimtarët lokalë bizantinë, ashtu edhe për katalonasi e Barcelonës. Ata bëhen bartës të jetës politiko-ushtarake, duke mbrojtur "kufinj të brishtë të Bizantit" dhe njëkohësisht, ata sjellin frymë të re në proceset e vlimeve politike ndër rajonet fqinje të Maqedonisë së Greqisë dhe të Epirit. Po aq janë të vlefshëm në fushën e avansimit të blegtorisë e të bujqësisë, posaçërisht atëherë kur përfundojnë fazën e zënies vend në hapësirën e urbanizuar të një pjese të Tesalisë. Si të tillë, ato tri tarafe kryesisht, kanë rolin qëndror në shtrirjen e arbitrit tutje; ruajnë ritmin e evoluimit demografik krahasuar me fqinjët e tyre, duke i dhënë më pastaj helenizmit të raskapitur një gjak të ri.

5. Konkluzione

Në praktikën e studimeve demografike, sfondi motivues i shtegtimeve dhe i shpërnguljes të një grupi etnik apo e një pjese të tij nga djepi amë, zakonisht identifikohet brenda rrethanave politike e ekonomike. Një kontekst i tillë, mbase vlen dhe qe domëthënës, edhe për fenomenin e zbrasjes të arbitrit mesjetar nga toka e deti i Arbërisë. Nëse kihet parasysh aspekti politik, që

cyti fillimisht lëvizjet e paefektshme brenda hapësirës etnike shqiptare dhe më vonë "marrjen e botës në sy" atëherë po ky aspekt ndërlihet ngusht dhe ushqen krizën e thellë ekonomike.

Kam parasysh këtu Shqipërinë e shek.XIII, një vend ky kontradiktor e hapësirë mozaiku, me status dhe gjendje të ndryshme sociale. Këtu sundonte një trup i huaj feudalësh të Napolit, që administroi me Arbërinë në dëm të fshatarëve e qytetarëve të varfër, duke krijuar kushte e premisa migrimi. Për fat të keq, gjendjes së tillë do t'i kontribuojnë edhe pjesëtarët e aristokracisë së re shqiptare, të cilët, duke marrë tituj "princash" perëndimorë ose "arhondësh" që mbulonin Bizantin, hedhin shpejt anash traditën zakonore të Arbërisë.

Rrjedhimisht, ata dhe sundimtarët jashtë bërthamës etnike të tyre krijojnë hendekun e barazisë në qytete, po aq sa edhe kanë hise në prishjen e strukturave ekzistuese të familjeve të mëdha patriarkale. Pra, procesi i lëkundjes së dukshme të elementeve sociale, zhdukja e bërthamve arkaike, reflekton zbritjen e fshatarëve në qytete dhe në mungesë mjetesh materiale nxit trendin gradual negativ të shpërnguljes.

Në drejtimin e erozionit të barazisë dhe të ekonomisë në kushte të reja afarizmi në Arbëri, si dhe të uzurpimit të tokave nga anzhujët napolitanë, historia e mesjetës shqiptare njih një valë migrimi nga Shqipëria bregdetare, me gjasë në kuadrin e viteve 1269-1274.

Se në ç'masë është ndrydhur në numër prania e arbitrit, nuk mund të dihet saktë, po aq sa edhe për shtegtimet fillimisht të shqiptarëve në Shqipërinë e Mesme dhe vendosjen përfundimtare të tyre në Greqinë Veriore. Ishin ato fise të arbitrit, të cilët për terren të ngushtë gjeneze supozoj se kishin pasur Mallakastrën e Epërme e të Poshtme dhe që, për itinerar të lëvizjes deri në tokën e "premtuar" shfrytëzuan Egnatinë".

Literatura bazë historike dhe e burimeve të botuara bizantine e latine bën fjalë për ngulimet e organizuara të tyre që nga viti 1295, 1300, pra para motit 1315 kur ata përmenden, si faktorë politik e ushtarak në të ardhmen. Kihej të bëhej

për shpërthimin demografik të tyre në Tesali, rajon ky që zyrtarizon procesin nismëtar të shpërnguljes së arbitrit dhe që disa dhjetëvjeçarë më heret, vullnetshëm i ishte kundërvënë pranisë së ardhacakëve të ri nga Shqipëria e Jugut.

Bibliografia

BOZHORI, Koço – LIÇO, Filip (1975), *Burimet tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek.X-XV)*, Tiranë.

CANTACUZENI, Ioannis (1828 – 1832), *Eximperatoris Historiarum, Libri II, Vol.I, Ed. Weber, Boanne;*

DUCELLIER, Alain (1986), *Δημογραφία, μεταναστεύσης και πολιτιστικά σύνορα από τα τέλη του μεσσαίωνα στην νεωτέρη εποχή, “Τα ιστορικά”, 5, Αθήνα.*

DUCELLIER, Alain (1994), *Οί Αλβανοί στην Ελλάδα, Η μετανάστευση μιάς κοινότητας, Αθήνα. .*

GREGORAE, Nicephori (1829), *Historia Byzantinae, Vol.I, ed. Weber, Bonae;*

ΒΑΚΑΛΟΠΟΥΛΟΣ, Απ. (1961), *Ίστορία του Νέου Έλληνισμού Α, Θεσσαλονίκη.*

HISTORIA e popullit shqiptar I, Prishtinë (botimi i tretë), Prishtinë.

JACOBY, Charles (1974), *Turcs et Venetians en romaine (1305 – 1332), un nouveau temoignage de Marino Sanudo Torselo, “Studi Medieva” 3, serie XV, Roma.*

JOCHALAS, Titos (1971), *Über die einwanderung der Albaner in Griechenland, “Disertationes Albanicae” XIII, München.*

KERSOPOULOS, Jean (1937), *Chronologie Albanaise, Athenes.*

ΜΠΙΡΗΣ, Η. (1960), *Κώστας, Άρβανίτες, οί Δωριείς τού Νεωτέρου Ελληνισμού Αθηναί.*

MIKLOSICH, F – MÜLLER (11860 – 1887), *Acta et diplomata graeca medii aevi Sacra et profana V, Wien.*

RUBIO Y LLUCH, A. (1947), *Diplomatari de l’Orient Catala(1301-1409), Barcelona.*

SHKODRA, Zija (1992), *Kontribut për historinë e diasporës shqiptare, “Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve”, Prishtinë.*

SHUFFLAY, Millan (1968), *Serbët dhe shqiptarët, Prishtinë.*

ZAKYTHINOS, D. A. (1953), *Le despotat grec de Morée I, Athènes.*

ΠΟΥΛΟΣ, Χρ. Ιωάννης (), *Ή έποίκησης τών Άλβωνών εις Κορινθίαν, “ Επετηρίς τού Μεσαιωνικού Αρχείου Ακαδημίας Αθηνών, τ. Γ, έν Αθήνις.*

ΣΟΥΛΗΣ, Γ. Χ. (1953), *Περί τών μεσαιωνικών φύλων τών Μαλακασίων Μπουϊων και Μεσαριτών, “Επετηρίς Εταιρίας Βυζαντινών Σπουδών έτος Κ.Γ. Αθήναι.*